



Në mbështetje të nenit 9 të Ligjit bazik Nr. 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-102 dhe Ligjin Nr. 04/L-223, Drejtori i Përgjithshëm i Administratës Tatimore të Kosovës, nxjerr:

## **VENDIM SHPJEGUES PUBLIK NR. 3/2016 PËR VLERËSIMET DHE RIVLERËSIMET DOGANORE**

### **QËLLIMI**

Qëllimi i këtij Vendimi Shpjegues Publik është të sqaroj detyrimet tatimore, mënyrën e deklarimit dhe pagesës së Tatimit mbi Vlerën e Shtuar, Tatimit në të Ardhurat Personale dhe Tatimit në të Ardhurat e Korporatave, për tatimpaguesit, veprimtaria e të cilëve është e lidhur me importin e mallrave / pajisjeve, në rastet kur këto importe iu nënshtrohen Vlerësimeve apo Rivlerësimeve Doganore.

### **PËRKUFIZIM**

Për qëllimin e këtij Vendimi Shpjegues Publik, përkufizimi në vazhdim ka këtë kuptim:

**Dokument Unik Doganor** - dokumenti që ka formën e përcaktuar me Legjislacion Doganor, i cili shfrytëzohet brenda strukturës së tregtisë së mallrave me shtetet e treta duke përfshirë Procedurat e Doganës të lidhura me këtë tregti.

### **BAZA LIGJORE**

Neni 13, paragrafët 3 dhe 5 të Ligjit Nr. 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat, përcaktojnë krijimin dhe mbajtjen e regjistrave, citojmë:

“3. Librat dhe regjistrimet për bizneset me qarkullim vjetor mbi pesëdhjetëmijë (50.000) euro duhet të mbahen në përputhje me parimet e përgjithshme të pranueshme të kontabilitetit të Kosovës që janë plotësuar me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

5. Mallrat që posedon tatimpaguesi duhet të dokumentohen me dokumente mbi origjinën.”

Neni 19, paragrafi 8 i Ligjit Nr. 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat, përcakton lejimet e zbritjeve për të përcaktuar të ardhurat e tatueshme, citojmë:

“8. Për përcaktimin e të ardhurave të tatueshme, tatimpaguesit i lejohet zbritje nga të ardhurat bruto për shpenzimet e bëra dhe të paguar brenda ose jashtë vendit, nëse ato janë bërë gjatë periudhës tatimore në tërësi dhe ekskluzivisht përkitazi me veprimtarinë e tij ekonomike dhe nëse ato janë të dokumentuara si shpenzime dhe pagesa të bëra.”

Neni 17, paragrafi 4 i Udhëzimit Administrativ Nr. 15/2010 për zbatimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat, përcakton kërkesat për libra dhe regjistrime, citojmë:



